



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 520, datë 03.11.2021**

**PËR**  
**ULJEN E NGARKESËS SË GJYQTARES SË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR**  
**BERAT, ZNJ. KLEJDA ÇAPJA**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 174/a, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61 dhe 89, shkronja b) të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 25 pika 3, shkronja d) dhe dh) të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nenin 26 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas shqyrtimit të kërkesës së gjyqtarës Klejda Çapja, protokolluar me aktin nr. 4915 prot., datë 25.10.2021, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

**VENDOSI:**

1. Uljen e ngarkesës së gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, znj. Klejda Çapja nëpërmjet:
  - (i) përjashtimit tërësisht nga procedurat e ndarjes së çështjeve me short në gjykatën ku ushtron funksionin për një periudhë 2-mujore, si dhe;
  - (ii) rindarjes me short të çështjeve që ka në shqyrtim, për të cilat ligjet procedurale parashikojnë afat ligjor shqyrtimi dhe atyre me të pandehur me masa sigurimi “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi”.
2. Ngarkohet Kryetari dhe Kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Njoftimin e këtij vendimi znj. Klejda Çapja dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**